



KONFERENCA E PARË, 15.06.2017

“SHËNDETI I GJIMNAZISTËVE DHE STUDIME TË INTEGRUARA TË FUSHAVE BIOMJEKËSORE”

**SHKOLLA E MESME JOPUBLIKE “IBRAHIM KODRA”, DURRËS
LËNDA: BIOLOGJI**

PROJEKT Nr. 3

Tema: “Kariesi dentar dhe higjena dentare”



**Punoi: Gledis MUSABELLIU
Marsejda MEMOLLA
Sara QELIA
Megi AGALLIU**


Udhëhoqi: Dr. Laura GJYLI

Durrës, 2017



➤ *Objektivat e Realizuara*

- Dhëmbi si koncept ;
- Anatomia e dhëmbit;
- Histologjia e dhëmbit;
- Formula dentare tek fëmijët;
- Formula dentare tek të rriturit;
- pH normal oral;
- Faktorët të cilët ndikojnë në prishjen e dhëmbëve;
- Sëmundjet të cilat prekin dhëmbët:
- Kariesi dentar;
- Patogjeni që shkakton kariesin dentar;
- Higjena dentare;
- Aspektet psikologjike;
- Stadet e prishjes së dhëmbëve ;
- Studimet më të fundit molekulare lidhur me dhëmbët;
- Statistikat;
- Dita Botërore e shëndetit të gojës;



➤ Dhëmbët


- Dhëmbët janë kocka të cilat gjenden në gojë, pra përbejnë pjesë në kockat e kafkës
- Ata funksionojnë në mënyrë mekanike për ndarjen e ushqimit në pjesë dhe përgatitjen e tij për kalim në pjesën tjetër të sistemit të tretjes.
- Rrënjët e tyre janë të ngulitura në *Maxilla* (nofullën e sipërme), *Mandibulë* (nofullën e poshtme) dhe janë të mbuluara nga mishërat e dhëmbëve. Përbëhen nga inde të shumëta me dendësi dhe fortësi të ndryshme.



➤ Anatomia e dhëmbit

➤ Dhëmbi është i përbërë nga tre pjesë:



1. **Kurora:** është pjesa e dukshme e dhëmbit dhe ndodhet sipër mishrave (gingiva);
2. **Qafa:** është zona e dhëmbit, në linjën e mishrave midis rrënjës dhe kurorës;
3. **Rrënja** është zona e dhëmbit që ndodhet nën mishrat e dhëmbëve.
4. **Smalti** është indi më i fortë dhe më i mineralizuar në tërë organizmin ai mbështjellë kurorën e dhëmbit.
5. **Dentina** është komponenti kryesor i pjesës së brendshme të dhëmbëve . Ajo është elastike dhe e kompresuar në kontrast, me shkëlqimin natyral të smaltit.
6. Vec këtyre bëjnë pjesë dhe **nervat dhe venat** e gjakut dhe **kockat**.
7. **Pulpi** formon dhomën kryesore të dhëmbit. Pulpi është i përbërë nga qeliza të buta, që përmbajnë enë gjaku për të sjellë ushqim në dhëmbë dhe nerva të aftë, që të ndiejnë nxehtësinë dhe të ftohtin.



© Healthwise, Incorporated

➤ Histologjia e dhëmbit

- Shumica e indeve të forta në dhëmbë është **dentina**, një ind i veçantë i kalcifikuar, që rrjedh nga *mesenchym*. Dhëmbi është e lidhur me pas me kocka nga ligamenti periodontal, i cili ka pako të gjera të fibrave të kolagjenit dhe është ngulitur në kreshtën kockore të quajtur kurriz alveolar.
- Qendra e dhëmbit është e përbërë nga një zgavër e pulpës që shtrihet poshtë përmes rrënjëve si një kanal rrënjor.
- Gingiva është emri i mukozës së gojës që mbulon dhëmbin.
- Dentina është bërë nga *odontoblastet*, që shtrihen në kufirin e saj të brendshëm. Prodhimi i dentinës është i kufizuar në sipërfaqen e pulpës. Rreth 90% e dentinës është kolageni, dhe rreth 70% e peshës së lagësht është *hydroxyapatit*.




➤ Formula dentare tek të vegjëlit

- Dhëmbët e Qumështit fillojnë të dalin zakonisht gjatë periudhës gjashtë deri në tetë muajshe tek foshnjat ku së pari dalin dhëmbët e poshtëm prerës gradualisht të tjerë deri në moshën dy vjet e gjysmë. Dhjetë dalin në nofullën e sipërme dhe dhjetë në nofullën e poshtme, pra në total 20.

- $I:c:p=2:1:2$

- I=incisors (Prerës)
C=canine (Shqyerës)
P=premolar (Grirës)



➤ Formula dentare tek të rriturit

- Në mesin e dhëmbëve të përhershëm, 16 janë në nofullën e sipërme dhe 16 në nofullën e poshtme. Dhëmbët e parë të përhershëm dalin rreth moshës 6 vjeçare.
- Këta janë 28 ndërsa përfshirë këtu dhëmballët e pjekurisë të cilat paraqiten gjatë moshës 20 vjeçare, në total janë 32.



$$\blacksquare I:c:p:m=2:1:2:3$$

I= incisors (Prerës)

C= canine (Shqyerës, dhëmbët e qenit.)

P= premolar(Grirës)

M= Molar(Bluajtës).



➤ **pH normal, oral**

- Një gojë e shëndetshme është një mjedis jo-acid neutral, me një **pH 7.5** ose më lart.
 - Rrënjët e dhëmbëve fillojnë të shpërndahen pasi *pH normal* neutral ulet në **6,5** dhe kur nivelet e aciditetit ulen në **5,5**. Kur pH ulet në **5.2 – 5.5** mjedisi i dhëmbit nuk është i ngopur me jone kalciumi dhe fosfori kështu smalti fillon të demineralizohet.
 - Kur dekalcifikimi arrin në nivelin smalt – dentin, dekalcifikimi acid i dentines mund të progresojë dhe vetë bakteriet mund t'i shkatërrojnë ato përmes proteolizës.
 - Për dhëmbë të shëndetshëm, ekspozimi ndaj aciditetit duhet të mbahet në minimum.

➤ Faktorët që ndikojnë në prishjen e dhëmbëve


➤ Sipas stomatologëve disa nga faktorët që ndikojnë në sëmundjet e dhëmbëve janë:

- Mungesa e kujdesit;
- Konsumimi i duhanit;
- Ëmbëlsirat;
- Kequshqyerja;
- Lëngjet e frutave;
- Pijet energjike;
- Frutat të thata;
- Patetinat;
- Pijet dietike që përmbajnë sheqerna artificiale.





➤ Sëmundjet e dhëmbëve

- ***Kariesi dentar*** - janë hapsirat që krijohen në smaltin e dhëmbëve. Një ndër shkaqet kryesore të kariesit është mbledhja e pllakës. Pllaka dentare është një depozitim i bardhë dhe i butë i cili krijohet në sipërfaqet e dhëmbëve.
- Formohet kur bakteret bashkohen me pështymën dhe ushqimin. Pllaka përmban rreth 400 lloje bakteresh. Bakteret në pllakë formojnë acid pas reaksionit të tyre me sheqerin dhe niseshten që ndodhet në ushqime. Acidet mbahen në kontakt me dhëmbët me ndihmën e pllakës dhe me kalimin e kohës shkatërrojnë smaltin dhe dentinën.
- Bakteri kryesor përgjegjës për prishjen e dhëmbëve është ***Streptococcus mutans***.



➤ ***Kariesi dentar*** mund të vendoset në:

1. *Sipërfaqen përtpëse,*
2. *Hapësirat ndërmjet dhëmbëve,*
3. *Në qafën e dhëmbëve.*





- **Gingivitet** – (Sëmundja e mishrave të dhëmbëve) është inflamacioni i mishrave të dhëmbëve dhe dëmtimi i kockës që mban të vendosur dhëmbët në nofull.

Shkaktojnë gjakderdhje gjatë furcimit të dhëmbëve, dhimbje, lëvizje të dhëmbit ose rënie të tij.

- **Era e keqe e gojës** (halitosis) shkaktohet nga higjiena e keqe e gojës, mospastrimi i gjuhës, tharja e fytit, ushqimet dhe pijet e konsumuara.



➤ Higjena e gojës

1. Dhëmbët të lahen **3** herë në ditë.
2. Furça e dhëmbëve mbahet në një kënd prej **45 °** nga këndi i dhëmbëve.
3. Me pak forcë, shpërndani pastën në dhëmbë, dhe filloni të lani dhëmbët ngadalë.
4. Kur lani dhëmbët duhet të keni parasysh, që t'i lani mirë në sipërfaqen ku kafshohet.
5. Tek dhëmbët frontale dhe ata të qenit, furça mbahet në drejtim horizontal, sipas figurës.
6. Furca e dhëmbëve duhet te ndrohet **3-6** muaj.
7. Duhet të bëhet kontroll çdo 6 muaj tek dentisti.



➤ Ushqimet të cilat dëmtojnë dhëmbët

1. Sheqerkat, kamelet, ëmbëltuesit -mund të ngjiten në sipërfaqen e dhëmbit dhe u duhet shumë kohë që të shpërbëhen. Disa prej tyre janë aq të forta saqë mund të shkaktojnë thyerjen e dhëmbit nëse i kafshoni..



2. Ushqimet acidike –janë të dëmshëme për dhëmbët



3. Pijet e gazuara dhe energjike –janë veçanërisht të dëmshme për dhëmbët nëse pihen shpesh.

4. Alkooli: mund të çojë në sëmundje të mishit të dhëmbëve.





➤ Ushqime të shëndetshme për dhëmbët

1. **Uji** – është i pazëvendësueshëm dhe me të duhet shpëlarë dhëmbët pas ngrënies ose pas konsumimit të pijeve të ëmbëltuara.
2. **Produktet e qumështit** – ato ripërtërijnë sasi të kalçiumit, i cili është i nevojshëm për shëndetin e dhëmbëve.
3. **Arrat** – janë të pasura me vitamina, minerale, kalium, kalçium dhe zink, dhe janë të shëndetshme për dhëmbët tuaj.
4. **Çaji i gjelbër** – parandalon rritjen e baktereve dhe ndihmon në luftën kundër inflamacionit të mishit të dhëmbëve dhe formimin e shtresave.



➤ Stadet e prishjes së dhëmbëve

- **Kur dhëmbët fillojnë të prishen** ata mund të diktohen vetëm nga dentisti pasi është vështirë të kuptohen me sy të lirë në fazat e para, nuk duhet pritur që të fillojnë dhimbjet për të shkuar te dentisti. Në fazën e parë prishja e dhëmbit nuk jep asnjë shqetësim, por me avancimin e prishjes mund të ketë ndjeshmeri me ushqimet dhe pijet e ëmbla, të ftohta e të nxehta.
- **Me avancimin e mëtejshëm** të prishjes, dhëmbi në vendin e prishur mund të marrë ngjyrë të zezë, gri, kafe ose të bardhë si shkumësi. Nëse edhe në këtë fazë nuk bëhet mjekimi i tij atëherë si pasojë e zgavrës së formuar në brendësi të dhëmbit mund të thyhet pjesa sipërfaqesore.



- **Faza tjetër është** thërrmimi i dhëmbit, dhimbje të herëpashershme dhe infektimi i rrënjëve si dhe përhapja e infeksionit në kockën e nofullës e në mishrat e dhëmbëve. Një prishje që nga fillimi dhe derisa të nisin dhimbjet do rreth 3 vjet që të zhvillohet.

➤ Studimet e fundit shkencore për heqjen e dhëmbëve.



➤ ÇFARË ËSHTË HEQJA E DHËMBIT?

Heqja e dhëmbit është zhvendosja e tij nga pozicioni i cili quhet foleja e tij.



• SI MUND TË REALIZOHET KJO PROCEDURË?

Dy janë mënyrat e heqjes së dhëmbit: mënyra e thjeshtë dhe ajo kirurgjikale.



➤ QELIZAT STAMINALE PËR KURIMIN E DHËMBËVE

- Një grup studiuesish në *Institutin Wyss* të Harvardit, të udhëhequr nga *David Mooney* ka arritur të rikuperoj dëmtime të gradëve të rënda të dhëmbëve duke aplikuar këtë mënyrë. Studiuesit kanë zhvilluar një teknikë duke përdorur një lazer me fuqi të ulët për të stimuluar qelizat staminale në dentinën e reformimit, të cilat mund të kenë implikime për stomatologjinë, shërimin e plagëve dhe restaurimin e kockave.
- Një mënyrë tjetër që është zbuluar kohët e fundit është dhe **mbjellja e dhëmbëve** e cila po vjenë po shtohet dita ditës.




Përdorimi i *qelizave staminale* të dhëmbëve për të rritur dhëmbët dhe nofullat e reja do të kishte avantazhe mbi teknikat ekzistuese të zëvendësimit të dhëmbëve dhe mund të përdoret edhe për të rindërtuar nofullën e pacientit pas një dëmtimi të rëndë

➤ Kuriozitet

Është zbuluar se një medikament që tashmë është provuar në pacientët e *Alzheimer* mund të inkurajojë rigjenerimin e dhëmbëve dhe riparimin e dëmtimit të dhëmbëve. 7

Studiuesit në *King's College* në Londër zbuluan se droga **Tideglusib** stimulon qelizat burimore që gjenden në pulpë dhëmbësh në mënyrë që ata të gjenerojnë dentinë e re - materialin e mineralizuar nën smalt. Dhëmbët tashmë kanë aftësinë e rigjenerimit të dentinës nëse pulpa brenda dhëmbit bëhet e ekspozuar përmes traumës ose infeksionit, por natyrshëm mund të bëjë një shtresë shumë të hollë dhe jo të mjaftueshme për të mbushur zgavrat e thella të shkaktuara nga prishja e dhëmbëve.




➤ Statistika

Vetëm 60% e popullsisë, akses në kujdesin oral

60-90% e nxënësve në gjithë botën vuajnë nga kariesi dentar. Incidenca e kancerit oral shkon nga 1 deri në 10 raste për **100.000** njerëz në shumicën e vendeve. Dhembja e dhëmbit është një ndër arsyt kryesore për mungesat në shkollë të nxënësve në shumë vende. Në vendet e zhvilluara barra e sëmundjeve orale është në rënie, ndërsa komplikacionet janë më të zakonshme, sidomos te pjesa më e moshuar e popullsisë.. Risku për t'u prekur nga kanceri oral është 15 herë më i lartë kur kombinohen bashkë dy faktorët kryesorë të riskut, duhani dhe alkooli. **90 % e** popullsisë së botës do të vuajnë të paktën një herë nga një sëmundje në gojë në jetën e tyre.

Gati **60%** e popullsisë sidomos burra kanë dhëmbë të prishur ,femrat kane **55%**, Dhëmbë qe mungojnë jane **35%** burra dhe **40%** femra dhe të mbushur gati **10%** burra,dhe **7%** femra.



➤ Dita Botërore e Shëndetit të Gojës

- Dita Botërore e Shëndetit të Gojës e vendosur nga **Federata Dentare Botërore** (FDI), organizohet çdo vit më datë 20 mars. Kjo ditë synon të rrisë ndërgjegjësimin si dhe të tregojë rëndësinë e madhe që ka shëndeti oral në shëndetin e përgjithshëm dhe mirëqenien. Mesazhi që “**Dita Botërore e Shëndetit Oral**” na jep është që të promovojmë buzëqeshje të shëndetshme.



➤ *Faleminderit p r v mendjen !*

